

Takimi i II i Grupit të Referencës për Mbrojtjen Proaktive të Pavarësisë së SAI-ve organizuar nga IDI

Pragë, 24-28 prill 2023

Në datat 24-28 prill 2023 u zhvillua në Pragë, takimi i II i Grupit të Referencës organizuar nga IDI mbi Mekanizmin Proaktiv të Mbrojtjes së Pavarësisë së SAI-ve, SIRAM.

INTOSAI ka mbështetur dhe promovuar gjithmonë pavarësinë e SAI-ve si mjeti për përmbushjen me objektivitet dhe efektivitet të detyrave të tyre.

Në këtë kuadër, Inisiativa e INTOSAI-t për Zhvillim IDI, ka zhvilluar një linjë mbështetjeje dhe avokatie në nivel global e rajonal në zbatim të plotë të përcaktimeve në Deklaratat e Limës dhe Meksikës, në mbështetje dhe mbrojtje ndaj çdo kërcënimi që mund t'i adresohet Pavarësisë së SAI-ve, të tilla si ndryshimet në kushtetutë apo ligj, sfidave për mandatin e SAI-t, si dhe ndaj tentativave për të hequr titullarin e SAI-t apo vonesat në emëtime.



Në fokus të këtij takimi ishte rajoni i EUROSAT-t, me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga SAI-t e Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Gjeorgjisë, Rumanisë, Armenisë, Polonisë, Qipros, si dhe përfaqësues të SAI-t të Spanjës në cilësinë e sekretariatit të përgjithshëm të EUROSAT-t dhe Austrisë në cilësinë e sekretariatit të përgjithshëm të INTOSAI-t.

Objektivat kryesorë të këtij takimi ishin:

- Grumbullimi i informacionit në nivel rajonal mbi SIRAM dhe reflektimi i dimensionit të rasteve në këtë kontekst;
- Vlerësimi i kapaciteteve për t'iu përgjigjur kërcënimeve ndaj pavarësisë në kohë dhe në mënyrën e duhur;
- Angazhimi i grupeve të interesit dhe komunikimi në nivel rajonal;

Vëmendje të veçantë mori prezantimi i rasteve konkrete të kërcënimeve ndaj pavarësisë institucionale të SAI-ve, aktualisht duke u trajtuar nga IDI, të përcjella nga SAI-t e Malit të Zi, Polonisë, Qipros dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në përfundim të prezantimeve, IDI vuri në dukje se prej vitit 2018 që është prezantuar për herë të parë ky mekanizëm, ekziston një lidhje ndërmjet trendit të ulët të përgjegjshmërisë në nivel rajonal me kërcënimet e raportuara ndaj Pavarësisë së SAI-ve dhe se ky trend, pritet të jetë në rritje për vitet në vazhdim.



Diskutimet e zhvilluara ndërmjet përfaqësuesve të SAI-ve të pranishëm dhe IDI-t dhanë gjithashtu kontribut në qartësimin e funksionimit të këtij mekanizmi, duke nënvizuar se janë disa elementët të cilët ndikojnë në funksionimin më të mirë të tij, si vijon:

- ndërgjegjësimi ndërmjet SAI-ve për ekzistencën e SIRAM;
- bashkëpunimi në kohë reale ndërmjet SAI-ve dhe IDI-t, por edhe strukturave të tjera në nivel rajonal e më gjerë;
- bashkëpunimi ndërmjet SAI-ve dhe grupeve të interesit, veçanërisht medias në denoncimin e kërcënimeve të mundshme;
- angazhimi dhe bashkëpunimi me Parlamentet, Ministrinë e Financave, Prokurorinë e Përgjithshme, Organizatat e Shoqërisë Civile, etj;
- grumbullimi i të dhënave për rastet e ngjashme;
- krijimi i kushteve të duhura për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalëshe me këto institucione;
- zhvillimi dhe krijimi i metodologjive për identifikimin e dobësive dhe vulnerabilitetin në kuadrin ligjor respektiv;

Takimin e përshëndetën z. Miloslav Kala, President i SAI-t të Republikës së Çekisë, njokohësisht edhe President i EUROSAT-t si dhe z. Bruno Dantas, President i SAI-t të Brazilit, njëkohësisht President i Bordit Drejtues të INTOSAT-t, të cilët falenderuan IDI-n për mbështetjen dhe theksuan edhe një herë rëndësinë që ka Pavarësia e SAI-ve dhe mbi të gjitha denoncimi i të gjitha rasteve kërcënuese ndaj saj.

